



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:006921

Datë: 20.05.2022

Numri i dokumentit: 03035339

**AC.nr.10632/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ME SELI NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, e përbërë nga Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari Besnik Feka dhe antarët e kolegjit-gjyqtarët Frosina Sylejmani dhe Arsim Hamzaj, në çështjen juridike të paditësve F., E.E., E. të gjithë me mbiemrin K., me banim në fshatin .../Komuna e Pejës, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit S. A., avokate nga Peja, rr. “...” 21, h-1, b-5, kundër të paditurëve Kompania e Sigurimeve KS “I...” me seli në Prishtinë, rr. “...” nr. ..., A.(M.) M. dhe M. M.që të dy nga Peja rr. “...” nr. ..., për shkak të kompensimit të dëmit-vlera e kontestit 20,000 euro, gjykata, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e autorizuar e paditësve avokate S. A.nga Peja, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me numër C.nr.1617/19, datë 16.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.05.2022, nxjerr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**I.APROVOHET SI E BAZUAR** ankesa e të autorizuarës së paditësve F., E., E. dhe E. të gjithë me mbiemrin Kelmendi nga Peja, avokate S. A. nga Peja, ndërsa **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm numër C.nr.1617/19, datë 21.10.2020, dhe lënda i kthehet në rivendosje të njëjtës gjykatë.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e ankimuar C.nr. 1617/19, datës 16.10.2020, ka vendosur si në vijim:

I.REFUZOHET propozimi i të autorizuarës së paditësve për vazhdimin e procedurës kontestimore në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve F.K., E.K., E.K.dhe E. K., L.K. (të cilin e përfaqëson kujdestarja e përkohshme E.K.) H.B. e lindur Kelmendi, të gjithë nga fsh. .../Komuna e Pejës, kundër të paditurëve KS. I... me seli në Prishtinë, rr. “UÇK-së, nr. 240, A.(M.) M.dhe M. M. që të dy nga Peja rr. “...” nr. 65, me bazë juridike kompensim dëmi me vlerë të kontestit 20,000 euro, të ndërprerë sipas aktvendimit C.nr.1617/19, të datës 16.10.2020.

Kundër aktvendimit të lartpërmendur, brenda afatit të përcaktuar ligjor ankesë ka ushtruar e autorizuar e paditësve avokate S. A. nga Peja për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktvendimi në fjalë të ndryshohet dhe kërkesepadia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është ushtruar nga të paditurit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në bazë të nenit 194, 208 dhe 209 pika (d), në lidhje me nenin 182 par.1, 182 par.2 pika (n) të LPK-së, gjeti se:

**Ankesa e të autorizuarës së paditësve avokate S.A.nga Peja është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se pas kthimit të lëndës në rivendosje, sipas propozimit të palës paditëse për përsëritjen e procedurës nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit CN.nr.93/19, dt:11.12.2019, Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Prgjithshëm në procedurën e rivendosjes me aktvendimin C.nr.1617/19, të datës 16.10.2020, ka ndërprerë procedurën kontestimore në këtë çështje juridike për shkak të falimentimit të të paditurës, gjegjësisht Kompanisë së Sigurimeve KS “I...” me seli në Prishtinë, ndërsa duke vendosur sipas propozimit të të autorizuarës së paditësve avokate S.A.nga Peja për zgjerimin në aspektin subjektiv të kërkesëpadisë së paditësve si dhe njëkohësisht edhe propozimin për vazhdimin e procedurës së ndërprerë kontestimore sipas aktvendimit të datës 16.10.2020, Gjykata Themelore në Pejë me aktvendimin C.nr.1617/19, të datës 21.10.2020, ka refuzuar propozimin e të autorizuarës së paditësve F., E., E., L., K. (të cilin e përfaqëson kujdestarja e përkohshme E.K.) H. B.e lindur K.i, të gjithë nga fsh. .../Komuna e Pejës avokate S. A.nga Peja me të cilin ka kërkuar vazhdimin e procedurës së ndërprerë kontestimore ashtu që, të aprovohet zgjerimi subjektiv i padisë në anën e palës së paditur ku si palë ndërgjyqëse në vend të të paditurës KS “I...” të hyjnë Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë dhe Banka Qëndrore e Kosovës me seli në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e ankimuar për refuzimin e propozimit të të autorizuarës së paditësve avokate S. A. për vazhdimin e procedurës së ndërprerë kontestimore, ka theksuar se propozimi për vazhdimin e procedurës së ndërprerë ndaj subjektivit i cili i është nënshtruar procedurës së falimentimit dhe nuk ekziston si subjekt i së drejtës, respektivisht të paditurës K.S “I...” sipas vendimit të lartëcekur të BQK-së numër 23-10/2019, i është hequr licenca dhe e drejta për operim në tregun e sigurimeve është i pabazuar. Mbi bazën e këtyre arsyeve, në përputhje me nenin 280 par1 të LPK-së, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e procedurës së ndërprerë kontestimore sipas aktvendimit C.nr. 1617/19, të datës 16.10.2020 dhe propozimin për vazhdim të të njëjtës e ka refuzuar të pabazuar.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, tani për tani nuk mund ta përkrahë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë në aktvendimin e ankimuar për faktin se nga shkresat e lëndës konstatohet se si palë të paditura me legjitimitet pasiv në këtë çështje juridike përveç të paditës në falimentim KS “I...” me seli në Prishtinë, në këtë çështje juridike janë edhe dy subjekte fizike dhe atë A.M. dhe M. M. që të dy nga Peja, të cilët janë të paditur sipas padisë së paditësve mbi bazën e kërkesës për kompensimin e dëmit për shkak të përgjegjësisë solidare ku konsiderohet se i padituri i dytë A.M. ka qenë ngasës i autormjetit “Opel Kadet”, me tabela të regjistrimit 221-KS-317, i cili vërtetohet se në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë pa patent shofer dhe në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë i moshës madhore dhe i njëjti është shpallë fajtor dhe është dënuar për veprën penale vepër të rëndë kundër sigurisë në komunikacion nga neni 171 al.5, lidhur me nenin 165 al.3 të LP-së së Kosovës, ndërsa i padituri i tretë M.M. është babai i të paditurit të dytë A.M., i cili është i paditur në këtë procedurë gjyqësore mbi bazën e përgjegjësisë solidare.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje, vlerëson se në rastin konkret, ndërprerja e procedurës nga gjykata e shkallës së parë sipas aktvendimit C.nr.1617/19, datë 16.10.2020, për shkak të falimentimit të të paditurës së parë KS “I...” nuk shkakton domosdoshmërisht edhe ndërprerjen e procedurës kontestimore edhe ndaj dy të paditurëve tjera A.M. dhe M.M., ngase e paditura e

parë KS “I...” (në likudim) në njërën anë dhe i padituri i dytë A. M. si dhe i padituri i tretë M.M. në anën tjetër nuk janë në bashkëndërgjyqësi unike në këtë proces kontestimor, referuar nenit 269 par.1 të LPK-së, mirëpo të njëjtit janë në bashkëndërgjyqësi materiale mes tyre dhe kanë pozitën e bashkëndërgjyqësimit të thjeshtë ashtu që, janë të pavarur mes tyre si palë të paditura, referuar nenit 268 të LPK-së.

Në rastin konkret duke sqaruar dhe vërtetuar pozitat procedurale të të paditueses KS “I...” në njërën anë (në likudim) dhe të paditurit të dytë A.M.dhe të paditurit të tretë M.M.në anën tjetër, ku konstatohet se të njëjtit janë në bashkëndërgjyqësi materiale ngase detyrimet e tyre në raport me paditësit burojnë nga e njëjta bazë faktike dhe atë aksidenti i komunikacionit dhe pasojat e shkaktuara në këtë aksident komunikacioni, duke vërtetuar gjithashtu faktin se pozita procedurale e tyre është e thjeshtë dhe e pavarur me njëri tjetrin, atëherë ndërprerja e procedurës kontestimore për shkak të falimentimit të të paditueses së parë KS “I...” nga gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në nenin 277 pika (d) dhe refuzimi i propozimit të të autorizuarës së paditësve për vazhdimin e procedurës kontestimore bazuar në nenin 280 par.1 të LPK-se, për gjykatën e apelit nuk janë të pranueshme dhe si i tillë aktvendimi i ankimuar për refuzimin e propozimit për vazhdimin e procedurës kontestimore duhet të anulohet, ngase i njëjti është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182 par.2 pika (n) të LPK-së, në lidhje me nenin 268 dhe 269 të LPK-së, ku gjykata e shkallës së parë efektin e aktvendimit për ndërprerje të procedurës kontestimore e ka zgjërë ndaj të gjithë të paditurëve të cilët në rastin konkret nuk e kanë cilësinë e bashkëndërgjyqësive unik, por të thjeshtë dhe të pavarur mes vete, sidomos i padituri i dytë dhe i tretë në raport me të paditurën e parë që i është nënshtruar procedurës së likuidimit të detyrueshëm nga autoriteti kompetent i BQK-së.

Neni 277 pika (d) si dhe neni 280 par.1 i LPK-së, flasin për arsyet e ndërprerjes së procedurës kontestimore sa u përket subjekteve juridike që i janë nënshtruar procedurës së falimentimit apo likuidimit të detyrueshëm, ndërsa vazhdimi i kësaj procedurë sipas nenit 280 par.1, i referohet faktit kur administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i subjektit juridik të falimentuar e marrin përsipër procedurën apo kur gjykata i thërret të njëjtit që ta bëjnë këtë sipas propozimit të palës kundërshtarë. Në rastin konkret baza ligjore e ndërprerjes së procedurës kontestimore dhe refuzimi i propozimit për vazhdimin e procedurës së ndërprerë kontestimore është kornizuar vetëm te e paditura e parë KS “I...” ndërsa ndërprerjen e procesit kontestimor e ka bërë edhe për dy të paditurit tjerë A. M.dhe M.M., duke mos dhënë arsye të qarta dhe vendimtare që kanë ndikuar në ndërprerjen e procedurës kontestimore dhe arsyet e refuzimit të vazhdimin të kësaj procedurë ndaj të paditurit të dytë dhe të tretë, dhe mungesa e prezentimit të këtyre arsyeve sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, përbënë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182 par.2, pika (n), në lidhje me nenin 160 par.4 dhe 5, e njëkohësisht në lidhje me nenin 175 të LPK-së, ngase aktvendimit ankimor i mungojnë arsyet vendimtare për refuzimin e vazhdimin të procedurës së ndërprerë kontestimore ndaj të paditurit të dytë dhe të tretë, të cilët nuk janë në bashkëndërgjyqësi unike me të paditurën e parë KS “I...”.

Në riprocedurë, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që të vlerësoj fillimisht faktin se a janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e procedurës sipas propozimit të të autorizuarës së paditësve, duke marrë për bazë edhe rekomandimet e lartëcekura të gjykatës së shkallës së dytë për vlerësimin e pozitës së bashkëndërgjyqësive nga ana e palës së paditur dhe të vendos meritorisht lidhur me propozimin në fjalë se a plotësohen kushtet ligjore për vazhdimin e procedurës kontestimore dhe nëse po ndaj kujt plotësohen kushtet ligjore që të vazhdohet procedura e ndërprerë kontestimore, ku bashkë me propozimin e ushtruar për vazhdimin e procedurës së ndërprerë kontestimore dhe pas vendosjes lidhur me të gjitha propozimet e ushtruara, nxjerrjes dhe administrimit të të gjitha provave si dhe plotësimin të të gjitha kushteve ligjore të vendosë meritorisht edhe për kërkesëpadinë e paditësve, duke marrë për bazë edhe urgjencën në vendosjen e kësaj çështje rigjyqëse dhe vjetërsinë e saj.

Numri i lëndës: 2020:006921  
Datë: 20.05.2022  
Numri i dokumentit: 03035339

Nga sa u tha më lartë, në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AC.nr.10632/21, me datë 17.05.2022**

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari**  
**Besnik Feka**